



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

A.nr. 1511/14

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtare Luljeta Maxhuni, dhe me sekretaren juridike Ujëvesa Hysenaj, në konfliktin administrativ të paditësit Nj.H. nga fshati S., komuna e V., kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale- Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovë, Prishtinë, për shkak të anulimit aktvendimit, në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur në prani të palës paditëse e në mungesë te palës së paditur, me dt. 09.11.2016, merr këtë:

A K T G J Y K I M

-Aprovohet si e bazuar, kërkesëpadia e paditësit Nj.H.nga fshati S., komuna e V..

-Anulohet Aktvendimi i të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Prishtinë, me nr. 5083315 të dt. 02.06.2014, dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike, është mbajtur në kuptim të nenit 41 të LKA-së, në prani të palës paditëse e në mungesë të palës së paditur të thirrura në mënyrë të rregullt.

Paditësi, Nj. H., në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se, qëndron pranë padisë dhe kërkesëpadisë duke i propozuar gjykatës që t'a anuloj vendimin me nr. i dt. 02.06.2014, me nr. 5083315. Me tutje shton se, këtë lloj sëmundje e ka që nga moshë 15 vjeçare dhe se komisioni nuk e ka vlerësuar këtë çështje.

E paditura në përgjigjen ne padi te dt. 26.09.2016, e ka njoftuar gjykatën se, mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi, duke i propozuar gjykatës që të refuzon padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, ndërsa të mbetet në fuqi aktvendimi i të paditurës, si i bazuar në ligj.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të dt. 09.11.2016, ka bërë administrimin e provave dhe atë: vendimi i dt. dt. 02.06.2014, me nr. 5083315; vendimi për personin me aftësi te kufizuar i dt. 22.01.2007; vendimi për personin me aftësi te kufizuar pas rivlerësimit i dt. 22.04.2008, dhe i dt. 15.10.2008; flete lëshimi me nr. 1664, i dt. 21.06.1986; fletë-lëshimi i dt. 08.04.1987, me nr. 165/87, i dt. 22.11.1986, dhe e dt. 09.09.1998, me nr. 2611, i dt. 05.08.99, me nr. 1632, i dt. 25.08.80, dt. 15.04.1998, i dt. me nr. 317, 05.08.99, me nr. 1632, i dt. 15.02.1987, me nr. 86-151-87, i dt. 12.11.1987, i dt. 15.05.1997, me nr. 634; raporti i specialisit i dt. 12.1187, me nr. 828; raporti i doktorit socialist i dt. 10.04.1997; raporti i ordinancës specialistike- ortoprrike " K.", me nr. 207; dokumenti i dt. 04.02.1987; dokumenti më nr. 165-87; konsultimi i nënshkruar nga Dr. R. Z.; raporti i mjekut i dt. 1986; vlerësimi i komisionit mjekësor- konstatimi i komisionit mjekësor i dt. 14.02.2014; shqyrtimi i ankesave i dt. 15.05.2014; ankesa e dt. 08.05.2014; vendimi për personin me aftësi te kufizuar i dt. 18.02.2014 dhe raporti nga konsulta i dt. 13.04.2014.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit të goditur me padi, në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar.

Nga aktvendimi i kontestuar del se ai përmban të meta të tilla për shkak të të cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 84 par. 2 të këtij ligji është paraparë se akti administrativ, që në këtë rast nënkupton vendimin e goditur me padi, duhet të përmbajë përveç tjerash edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike, bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruara nga administrata, një deklaram të bazës ligjore në të cilat bazohet akti etj. Akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar. Në nenin 85 të po të njëjtit ligji, parashikohet se përveç rasteve ku ligji vet e parashikon dhënien e arsyeve, duhet të jepen domosdoshmërisht arsyet për të gjitha ato akte, të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekën në një mënyrë apo tjetër të drejta dhe interesa ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime, përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara, ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar etj. Arsyetimet duhet të formulohen qartë dhe të përfshijnë shpjegimet e bazës ligjore dhe faktike të aktit.

Aktvendimi i kundërshtuar është juridikisht i paqartë dhe kundërtshënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsyet mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kundërshtuar. Në arsyetimin e vendimit është dhënë një formulim i përgjithshëm dhe abstrakt ku thuhet se Këshilli i Ankesave me ekspert mjekësor të lëmive përkatëse, duke vepruar sipas ankesës së paditësit Nj.H. të dt. 08.05.2014, në mënyrë të gjithanshme, në seancën e dt. 15.05.2014, i ka shqyrtuar shkresat e lëndës, pretendimet ankimore, dokumentacionin mjekësor, që gjendet në lëndë dhe vlerësimin e Komisionit Mjekësor të shkallës së parë të dt. 14.02.2014, dhe në përputhje me nenin 2.2 të Ligjit PPAK, ka konstatuar se nuk ka dëshmi të mjaftueshme për të qenë shfrytëzues i pensionit për persona me aftësi të kufizuara të plotë dhe të përhershme. Po ashtu në arsyetimin e këtij vendimit thuhet se Komisioni ekspert mjekësor nga shkalla e dytë, në seancën mjekësore, ka vlerësuar komplet dokumentacionin mjekësor, ku për bazë kanë marrë certifikatën e mjekësisë familjare të licencuar, dokumentacionin mjekësor, si dhe raportet nga specialistet dhe është konstatuar se nuk ka sjellë dëshmi të mjaftueshme për të përmbushur kriteret, për të qenë shfrytëzues i pensionit me aftësi të kufizuar të plotë dhe e përhershme, siç përcaktohet me ligjin 2003/23, me ç'rast e refuzon ankesën si të pabazuar dhe vërteton vendimin e shkallës së parë.

Me vendimin e të paditurës të dt. 22.01.2007, gjykata vëren se, paditëses i është miratuar kërkesa për Pensionin me Aftësi të kufizuar, nga dt. 15.06.2006, në periudhën kohore prej një (1) viti.

Me vendimin e dt. 22.04.2008, gjykata vëren se, paditëses i është miratuar kërkesa për Pension i Personave me Aftësi të Kufizuar, nga data 15.06.2007, në periudhën kohore prej një (1) viti.

Ndërsa, me vendimin e dt. 15.10.2008, gjykata vëren se, paditëses i është miratuar kërkesa për Pension i Personave me Aftësi të Kufizuar, nga data 15.06.2008, në periudhën kohore prej tre (3) viteve.

Me vendimin e të paditurës të dt. 18.02.2014, gjykata gjenë se, paditësit i është refuzuar kërkesa për Pensionin e Personave me Aftësi të Kufizuara, me konstatim se, arsye e refuzimit të kërkesës është "bazuar në vlerësimin e Komisionit mjekësor, i cili e ka vlerësuar aftësinë e kufizuar të ushtruesit së kërkesës, është ardhur në përfundim se te ju, aftësia e kufizuar e plotë dhe e përhershme nuk ekziston".

Në këtë kuptim, gjykata vlerëson se organi i paditur, nuk ka bërë farë arsyetim në vendimin e saj, se nga cila bazë paditëses i është rikthyer aftësia e plotë dhe e përhershme, kur me aktvendimin e datës 18.02.2014, i ka refuzuar kërkesën për pension, kurse nga vlerësimi i Komisionit mjekësor i dt. 14.02.2014 dhe te dt. 15.05.2014, nuk shihet se si ka ardhur deri në këtë përfundim, pasi që paditësi këtë të drejtë e ka

shfrytëzuar, nga data 15.06.2006, deri me datë 15.06.2007, nga data 15.06.2007, deri me datën 15.06.2008, dhe nga data 15.06.2008 deri me datën 15.06.2011, ku për këtë periudhë kohore, e njëjti i ka plotësuar kushtet për të qenë përfituese e Pensionit për Personat me Aftësi të Kufizuar të Plotë dhe të Përhershme.

Gjykata si rregull, konfliktin administrativ e vendosë në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga ana e organeve administrative, ndërsa nga aktvendimi i goditur në padi, nuk mund të kuptohet se si është vërtetuar gjendja faktike.

Të metat e cekura më lartë janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së aktvendimit të kundërshtuar dhe në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur që në afat prej 30 ditësh, në ri-procedurë të veprj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi t'i mënjanoj të metat e cekura, të merr aktvendim të drejtë të bazuar në ligj.

Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Duke u bazuar në të dhënat e lart cekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative
A.nr. 1511-14-data 09.11.2016

Sekretare Juridike
Ujëvesa Hysenaj

G j y q t a r e
Luljeta Maxhuni

Këshillë Juridike:

kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa,
në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të
njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë,
përmes kësaj gjykate.